

7 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.21/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Arbin Rushiti, i cili kthehet nga aktiviteti garues jashtë Republikës së Kosovës jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave **MIRATON** kërkesën e KB Vëllaznimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Arbin Rushiti.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

ARSYETIM


Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.21/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave i FBK-së, ka shqyrtuar kërkesën e klubit KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Arbin Rushiti, i cili kthehet nga aktiviteti garues jashtë Republikës së Kosovës, jashtë afatit kalimtar, konstatoi si në vijim:
- (b) Nga verifikimet e bëra nga Komisioni i Garave, bazuar në Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, rezultoi se në rastin konkret plotësohen kushtet e parapara me nenin 29 të kësaj rregulloreje, i cili rregullon regjistrimin e lojtarëve vendorë që kthehen nga aktiviteti garues jashtë vendit.
- (c) Duke u mbështetur në dispozitat e sipërpërmendura, Komisioni i Garave vlerëson se kërkesa e KB Vëllaznimi është e bazuar dhe në përputhje me aktet normative në fuqi.
- (d) Miratohet kërkesa e KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Arbin Rushiti, si lojtar vendor i kthyer nga jashtë Republikës së Kosovës me të drejta loje të menjëhershme.
- (e) Udhëzohet që lojtari Arbin Rushiti të regjistrohet për klubin KB Vëllaznimi me të drejtë loje të menjëhershme, në përputhje me rregulloret në fuqi të FBK-së.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.